

## Shtojca 2: Dokumentacioni i nevojshëm<sup>1</sup>

Kriteri Bazë	Nr.	Formës së kërkesës tuaj për të përfitur nga ky program i banimit social, duhet t'i bashkëngjitni këto dokumente të domosdoshme, si vijon:
Statusi i Banimit	1.	Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës - kopje për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 16 vjeçe;
	2.	Familja që jeton në shtëpi/banesë në kushte jo të mira, të papërshtatshme dhe që paraqet rrezik vazhdimi i banimit të mëtutjeshëm në të - Vërtetimi i vlerësuar dhe i konstatuar nga organet kompetente të fushës përkatëse nga komuna;
	3.	Familja e cila jeton në objekt nën normat minimale të banimit - Vërtetimi i vlerësuar dhe konstatuar nga organet kompetente të fushës përkatëse nga Komuna;
	4.	Vërtetimi se familja nuk ka pasuri të paluajtshme, banesë/shtëpi në vendin/komunën e origjinës prej nga vjen aplikuesi;
	5.	Nëse aplikuesi/familja është me qira - Kontrata e qirasë, e vërtetuar nga noteri;
Lartësia e të Ardhurave	6.	Certifikata e Kadastrës për tokën/pasurinë e paluajtshme - e paraqitësit të kërkesës dhe e anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu detajet e prindërve të vdekur dhe/ose kujdestarëve;
	7.	Vërtetimi nga organi përkatës komunal për lartësinë e tatimit mbi pronë - e aplikuesit dhe e anëtarëve të familjes që janë 18 vjeç apo më të vjetër. Këtu duhet të përfshihen edhe detajet e prindërve të vdekur ose kujdestarëve;
	8.	Vërtetimi se personi/familja është shfrytëzuese e ndihmës sociale - fotokopje kartela sociale me afat vlefshmërie;
	9.	Vërtetimi nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që aplikuesi apo ndonjëri nga anëtarët e familjes së tij, nuk kryejnë aktivitet tregtar;
	10.	Vërtetimi nga Departamenti i Punësimit për të gjithë anëtarët e familjes mbi moshën 18 vjeçe të cilët janë si kërkues pune, por që nuk janë të punësuar;
	11.	Vërtetimi punësimi nga punëdhënësi për çdo pjesëtarë të familjes, i cili është i punësuar në Institucione shtetërore apo në Sektorin privat, ku cilësohet pozicioni i punës dhe paga e fituar (neto);
	12.	Vërtetimi nga organet kompetente, i cili deklaron të ardhurat për personat të cilët janë në pension - Vendimi (original);
	13.	Vendimet e pensioneve të personave me aftësi të kufizuara (PPAK) nga MPMS-ja për anëtarët e familjes, duhet të jenë me afat të vlefshëm;
	14.	Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës për aplikuesin dhe anëtarët e familjes që janë 18 vjeç apo më tepër, këtu duhet të përfshihen gjithashtu edhe detajet e prindërve të vdekur ose kujdestarëve;
	15.	Dëshmia mbi gjendjen e llogarisë bankare për ekonomizim në Kosovë për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit të aplikuesit dhe anëtarëve të punësuar në familje;
Gjendja Shëndetësore	16.	Familjet me sëmundje të rënda kronike dhe me probleme të përhershme shëndetësore - Të dhënat mbi këtë gjendje serioze shëndetësore të aplikuesit apo të anëtarëve të tjerë, duhet të dokumentohen me vërtetim nga mjeku specialist ose komisioni i mjekësisë, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi;
	17.	Certifikata e mjekut për aftësinë e kufizuar - të aplikuesit dhe/ose e anëtarëve të tjerë të familjes, nëse parashtruesi i kërkesës apo pjesëtari tjetër i familjes paraqesin kërkesën në baza të aftësisë së përhershme të kufizuar;
Invaliditeti	18.	Dëshmi apo vërtetim mbi përcaktimin e shkallës së invaliditetit - gjendje e vërtetuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
Struktura e Familjes	19.	Certifikata apo deklarata e bashkësisë familjare;
	20.	Certifikatat e lindjes - për të gjithë anëtarët e familjes;
	21.	Ekstrakti i lindjes - vetëm për aplikuesin;
	22.	Vërtetimi mbi vendbanimin e përhershëm;
	23.	Çdo aplikues duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës së paku 5 (pesë) vjet para kohës së aplikimit - kjo vlen për personat e ardhur nga komuna tjera - të dëshmohet me dokumente relevante për këtë qëllim, p.sh. fletë shpërngulja nga komuna e ardhur;
	24.	Vërtetimi nga shkolla - për fëmijët nga mosha 6-18 vjeç dhe 18-25 vjeç, të cilët janë në shkollim;
	25.	Certifikata e kurorëzimit - për personat e martuar në familje, posaçërisht për bashkëshortin/bashkëshorten e aplikuesit, nëse ai person është i përfshirë në kërkesën e paraqitur;
	26.	Certifikata e shkurorëzimit, në rastin e çifteve të divorcuara që kanë një apo më tepër fëmijë në mbikëqyrje/përkujdesje prindërore - të dëshmohet me vendim gjyqësor për mbikëqyrjen/përkujdesin prindëror të fëmijës apo fëmijëve (originali ose i vërtetuar te noteri);
	27.	Familja e cila ka në mbikëqyrje dhe përkujdesje fëmijë/fëmijët jetimë - të dëshmohet kujdestaria me vendim nga autoritetet kompetente;
	28.	Të gjitha dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muajt nga dita e lëshimit të tyre;
	29.	Nëse ekziston arsyeja, do të kërkohen edhe dokumente të tjera shtesë.

<sup>1</sup>Udhëzimi administrativnr. 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit.